REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 2744/1 prot. Tiranë, më 16.10.2026

Lënda: Mendim mbi projektligjin "*Për miratimin e masave për zbatimin e aktit për tregjet digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit*"

**MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**Tiranë**

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit") ka administruar shkresën tuaj me nr. 7817 prot., datë 28.09.2026, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektligjin "*Për miratimin e masave për zbatimin e aktit për tregjet digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit*", së bashku me dokumentacionin shoqërues.

Fillimisht, sqarojmë se Zyra e Komisionerit ka shqyrtuar projektligjin në funksion të fushave të veprimtarisë që janë në kompetencën e institucionit, me synim përputhshmërinë e zbatimit të legjislacioneve respektive, shmangien e paqartësive, si dhe garantimin e ushtrimit efektiv të të drejtave dhe përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga legjislacioni në fuqi.

Kështu, nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektligjit vërejmë se ***në pikën 4 të nenit 3 të projektligjit*** parashikohet ruajtja e zbatimit të një sërë aktesh të legjislacionit sektorial, pa përfshirë shprehimisht legjislacionin për të drejtën e informimit.

Ndonëse mungesa e kësaj reference nuk cenon zbatueshmërinë e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, vlerësojmë se përfshirja e saj do të kontribuonte në sigurinë juridike, qartësinë dhe harmonizimin e kuadrit ligjor, veçanërisht në raport me dispozitat e nenit 29 të projektligjit, që rregullojnë përdorimin e informacionit dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

Në këtë kuadër, si sugjerim plotësues, propozojmë që ***në pikën 4 të nenit 3 të projektligjit*** të përfshihet edhe referenca ndaj "*...legjislacionit për të drejtën e informimit*", duke ruajtur strukturën dhe përmbajtjen e dispozitës.

Ndërkohë, Zyra e Komisionerit vlerëson përfshirjen e dispozitave që garantojnë respektimin e ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", si dhe parashikimin e bashkëpunimit të Autoritetit të Konkurrencës dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda kompetencave të tyre, për çështjet e mbrojtjes së të dhënave personale që lindin nga zbatimi i këtij ligji.

Për sa më sipër, konstatojmë se këto nene në tërësi janë përafruar me dispozitat e Rregullores (BE) 2019/1150 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 qershor 2019 "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online".

Megjithatë, me qëllim harmonizimin e saktë ***të pikës 3 të nenit 8 të projektligjit*** me pikën 3 të nenit 4 të Rregullores (BE) 2019/1150, sugjerojmë që togfjalëshi "*përpara fillimit të zbatimit të masës*" të zëvendësohet me togfjalëshin "*përpara se kufizimi, pezullimi ose ndërprerja të ketë hyrë në fuqi*", në mënyrë që të ruhet përputhshmëria terminologjike me aktin e BE-së dhe të shmangen paqartësitë në përcaktimin e momentit kohor deri në të cilin duhet të sigurohet aksesi në të dhënat përkatëse.

Në vijim, lidhur me ***pikat 1 dhe 2 të nenit 29 të projektligjit***, konstatojmë se në përcaktimin e qëllimeve për të cilat mund të përdoret informacioni i mbledhur ose i shkëmbyer gjatë zbatimit të ligjit është përdorur termi "vetëm", i cili nuk rezulton të jetë pjesë e formulimit të pikave përkatëse të nenit 36 të Rregullores (BE) 2022/1925, me të cilën synohet përafrimi.

Ndonëse këto dispozita rregullojnë qëllimin e përdorimit të informacionit nga autoritetet kompetente dhe jo drejtpërdrejt aksesin e publikut në të, vlerësojmë se përdorimi i termit "vetëm" mund të krijojë paqartësi gjatë zbatimit, nëse interpretohet si përjashtim i përgjithshëm i informacionit nga regjimi i së drejtës së informimit.

Në këtë kuadër, duke pasur parasysh nenin 23 të Kushtetutës, ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, si dhe Konventën e Këshillit të Evropës "Për aksesin në dokumente zyrtare", vlerësojmë se është e rëndësishme të shmangen formulimet që mund të krijojnë paqartësi në dallimin ndërmjet kufizimit të qëllimit të përdorimit të informacionit dhe kufizimit të aksesit publik në të.

Për sa më sipër, sugjerojmë heqjen e termit "vetëm" ***nga pikat 1 dhe 2 të nenit 29 të projektligjit***, me qëllim përafrimin sa më të saktë me formulimin e nenit 36 të Rregullores (BE) 2022/1925 dhe shmangien e paqartësive gjatë zbatimit të dispozitës. Gjithashtu, sugjerojmë verifikimin dhe saktësimin e referencës normative në fjalinë e fundit të pikës 2 të këtij neni, me qëllim identifikimin e qartë të aktit përkatës.

Lidhur me ***pikën 3 të nenit 29 të projektligjit***, vlerësojmë se parashikimi i detyrimit për ruajtjen e sekretit profesional dhe mbrojtjen e informacionit konfidencial është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave të ligjshëm gjatë zbatimit të ligjit. Megjithatë, formulimi i dispozitës kërkon saktësim lidhur me fushën e informacionit që mbulohet nga detyrimi për moszbulim.

Në këtë drejtim, sjellim në vëmendje se neni 36, pika 4, i Rregullores (BE) 2022/1925, e lidh detyrimin për moszbulim me informacionin e marrë ose të shkëmbyer në zbatim të Rregullores, i cili, për nga natyra e tij, mbulohet nga detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional. Gjithashtu, kjo dispozitë ruan shprehimisht mundësinë e shkëmbimit dhe përdorimit të informacionit në rastet e parashikuara nga rregullorja.

Në këtë kuadër, vlerësojmë se formulimi i pikës 3 të këtij neni duhet të përcaktojë qartë se detyrimi për moszbulim zbatohet ndaj informacionit që gëzon mbrojtje ligjore, pa u interpretuar si një ndalim i përgjithshëm i aksesit në informacionin e administruar nga autoritetet publike.

Sjellim në vëmendje se informacioni i administruar nga autoritetet publike, në parim, i nënshtrohet regjimit të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar. Për rrjedhojë, kërkesat individuale për informacion duhet të shqyrtohen në përputhje me këtë ligj, përfshirë kushtet dhe kriteret e kufizimit të aksesit sipas nenit 17, duke respektuar njëkohësisht detyrimet e posaçme të konfidencialitetit, që rrjedhin nga legjislacioni i zbatueshëm.

Sa i përket publikimit të vendimeve dhe raporteve në version jokonfidencial, vlerësojmë se ky parashikim përbën një mekanizëm të përshtatshëm për garantimin e transparencës, në përputhje me parimin e mbrojtjes së interesave të ligjshëm të subjekteve përkatëse. Publikimi i këtyre versioneve nuk duhet të interpretohet si përjashtim nga detyrimi për shqyrtimin e kërkesave individuale për informacion, përfshirë mundësinë e dhënies së aksesit të pjesshëm, sipas legjislacionit në fuqi.

Për sa më sipër, sugjerojmë saktësimin e fjalisë së parë ***të pikës 3 të nenit 29 të projektligjit***, në mënyrë që fusha e detyrimit për ruajtjen e sekretit profesional të përcaktohet në përputhje me nenin 36, pika 4, të Rregullores (BE) 2022/1925, duke garantuar njëkohësisht qartësinë e zbatimit të dispozitës në raport me legjislacionin për të drejtën e informimit.

Në përfundim, me përfshirjen e sugjerimeve të mësipërme, Zyra e Komisionerit vlerëson se projektligji është në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**